

VENDIM
Nr. 32, datë 20.2.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES
ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË QË
SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR PERIUDHËN 1
PRILL 2017 – 31 DHJETOR 2017**

Në mbështetje të nenit 16, 19, 47 dhe 83 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 6 pika 2 dhe 10 të VKM-së nr. 244 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, nenit 19 germa “c” të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 20.2.2017, mbasi shqyrtoi relacionin “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- ERE, me vendimet nr.191 datë 22.12.2016 dhe nr. 192 datë 22.12.2016, ka filluar procedurat për shqyrtimin e aplikimeve për tarifa të reja të shërbimit të transmetimit dhe ato të shpërndarjes për çdo nivel tensioni për vitin 2017, bazuar në aplikimet e shoqërive OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., respektivisht me shkresat nr.7260/1 datë 30.11.2016 dhe nr.29445 Prot., datë 9.12.2016.

- Shoqëria OSHEE sh.a., në aplikimin e saj për tarifë për vitin 2017, ka kërkuar mosndryshim të çmimeve për klientët fundorë por rialokim të kostove për nivele tensioni.

- OSHEE sh.a. ka paraqitur në ERE disa vlerësime/llogaritje lidhur me të ardhurat e kërkuara për aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë për vitin 2017 si argumente për mosndryshimin e çmimeve të shitjes me pakicë të klientët tariforë.

- Në shkresën nr.682 Prot., datë 31.1.2017, MEI shprehet se “Për të përmbyllur me sukses procesin e reformimit të sektorit elektroenergjetik është e nevojshme kryerja nga ana e ERE-s e një analize të drejtë të të ardhurave të kërkuara dhe kostove reale të operimit për secilën prej shoqërive publike, KESH, OST dhe OSHEE, me qëllim miratimin e tarifave përkatëse për vitin 2017 të cilat duhet të jenë transparente dhe të sigurojnë zhvillimin normal të aktivitetit në përputhje me kriteret që përcakton ligji dhe objektivat për qëndrueshmërinë e sistemit dhe stabilitetin financiar të sektorit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

